



Plani i Punës së Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik për 2011

I. Strategjia e AKK-së për periudhën 2011-2015

Vizioni dhe misioni i AKK-së i përcaktuar në Strategjinë për periudhën 2011-2015 (të aprovuar nga Bordi i AKK-së) sheh AKK-në në vitin 2015 si organizatë më të fuqishme dhe më efektive në:

1. Avokim në emër të komunave tek niveli qendror, dhe
2. Shërbim të nevojave të komunave anëtare

Me realizim të këtij vizioni dhe misioni do të dëshmohet dobishmëria dhe këmbëngulësia e AKK-së, dhe pritet që komunat do të paguajnë anëtarësinë në tërësi dhe kështu të sigurojnë qëndrueshmërinë financiare të AKK-së.

Rezultatet e pritura nga katër fushat strategjike të veprimit për realizim të vizionit dhe misionit janë:

1. Avokim dhe lobim pro-aktiv

- Interesat e komunave janë promovuar dhe mbrojtur tek qeveria qendrore, agjensionet ndërkombëtare dhe institucionet tjera relevante
- Aktivitetet lobuese janë koordinuar në mënyrë efektive për t'i mundësuar komunave të flasin njëzëri
- Legjislacioni që afekton kompetencat komunale është harmonizuar dhe shërben interesat e komunave

2. Zhvillim efektiv i kapaciteteve

- Koncepti afatgjatë dhe i bazuar në nevoja për zhvillim të kapaciteteve dhe trajnime për komuna është zhvilluar gradualisht dhe është duke u zbatuar
- Trajnim kualitativ i ofruar bazuar në kërkesa specifike të komunave

3. Përmirësim në ofrim të shërbimeve

- Funkionim efektiv i brendshëm i administratave komunale është përkrahur përmes harmonizimit të strategjive, akteve, organizimit si dhe procedurave relevante komunale të cilat shërbejnë qytetarët dhe sektorin privat
- Ofrim i ekspertizës së kualifikuar teknike dhe ligjore në fushat ku komunat dhe Kolegjiut nuk kanë ekspertizë të tillë
- Ofrim i shërbimeve specifike komunave të reja që nxisin integrimin
- Ofrim i këshillave të kualifikuara dhe lobim efektiv për financim nga palët e treta

4. Efiçenca organizative

- Në vitin 2015, AKK është një organizatë kompetente, e përparuar dhe financiarisht e qëndrueshme, me leverdi substanciale në procesin e decentralizimit
- Bordi dhe Këshilli i Kryetarëve ofrojnë udhëzime strategjike
- AKK, kryesisht përmes "Miqëve të AKK-së", mirëmban marrëdhënie të shkëlqyera me komunitetin e donatorëve ndërkombëtarë

II. Prioritetet e Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik në vitin e kaluar (2010)

1. Komunitatet të hartojnë strategjitë e tyre zhvillimore ekonomike lokale/komunale, të cilat janë të koordinuara me planet e tyre zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbane dhe planet rregullative urbane. Komunitatet gjithashtu mund të iniciojnë hartimin e planeve të përbashkëta zhvillimore ekonomike dhe hapësimore.
2. Komunitatet të nxisin bashkëpunimin e tyre ndërkomunal dhe ndërkufitar/ndërkombëtar në drejtim të realizimit të projekteve me efekte regjionale dhe me interes reciprok të komunave. Këto projekte mund të jenë pjesë e strategjive të tyre zhvillimore ekonomike lokale/komunale apo strategjive zhvillimore ndërkomunale/regjionale. Pesë Agjencitë e themeluara për Zhvillim Rajonal në Kosovë duhet të vazhdojnë të udhëhiqen nga komunitatet, si mënyra më e mirë për funksionimin afatgjatë të tyre.
3. Në drejtim të ofrimit të kushteve infrastrukturore për zhvillim të biznesit, komunitatet të shqyrtojnë mundësitë e ndërtimit të përbashkët të zonave ekonomike, në bazë të interesit reciprok dhe në përputhje me Ligjin e Zonave Ekonomike. Kjo do të racionalizonte përpjekjet individuale komunale për zona individuale ekonomike.
4. Themelimi i dialogut të mirëfilltë, produktiv dhe të rregullt në mes të autoriteteve komunale dhe bizneseve për të analizuar dhe zgjidhur problemet që bizneset hasin gjatë funksionimit të tyre të përditshëm.
5. Komunitatet, në dritën e realizimit të kompetencave të tyre ligjore, duhet të kenë të drejtën e themelimit të NP-ve Lokale në baza individuale apo regjionale, varësisht prej interesit të tyre dhe fizibilitetit tekniko-ekonomik.
6. MTI të vazhdojë të bëjë delegimin e përgjegjësisë Komunave në fushën e regjistrimit të biznesit. Ky delegim duhet të rrisë sinergjinë dhe bashkëpunimin në mes autoriteteve qendrore dhe komunave.
7. Komunitatet të themelojnë zyrat komunale për turizëm. Këto zyra komunale do të identifikonin të gjitha potencialet për zhvillim të turizmit lokal, identifikonin nevojat për investime infrastrukturore për të lehtësuar shfrytëzimin e këtyre resurseve turistike, si dhe krijonin zinxhirin e bashkëpunimit, koordinimit, dhe promovimit në mes të destinacioneve turistike, objekteve të trashëgimisë kulturore, turistëve & vizitorëve si dhe operatorëve ekonomikë.
8. Komunitatet të themelojnë "one-stop-shops" dhe qendra komunale për mbështetje biznesore, të cilat do të ofronin ndihmë dhe lehtësonin jetën ndërmarrësve që nga fillimi i procesit të themelimit të bizneseve ashtu edhe në procesin e mëtutjeshëm të afarizmit.
9. Komunitatet të iniciojnë projekte për rregullimin dhe konsolidimin e tokës bujqësore, me qëllim të shfrytëzimit sa më racional dhe më ekonomik të tokës bujqësore. Kjo do t'i ulte shpenzimet për njësi dhe do t'i bënte investimet bujqësore më efikente.
10. Në përputhje me strategjitë e tyre zhvillimore dhe fizibilitetit tekniko-ekonomik, komunitatet të analizojnë dhe identifikojnë mundësitë e implementimit të projekteve zhvillimore nëpërmjet angazhimit të partneritetit publiko-privat, në përputhje me Ligjin mbi Partneritetet Publiko Private dhe Koncesioneve në Infrastrukturë.
11. Komunitatet, në bashkëpunim me Qeverinë Qendrore të aplikojnë lehtësira fiskale për bizneset lokale, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, si dhe të aplikojnë të ashtuquajturat 'tax holidays', një mekanizëm fiskal që mundëson lirimin e bizneseve fillestare nga obligimet fiskale dhe obligimet tjera ndaj shtetit për një periudhë të caktuar kohore.
12. Komunitatet të mbështesin me programe trajnimi dhe financimi ato biznese që kanë vullnet të kyçen në programet e zhvillimit të fuqisë punëtore, që krijojnë vende pune të reja pune dhe avancojnë ato ekzistuese, si dhe ato biznese që maksimalizojnë të hyrat buxhetore. Komunitatet të targetojnë me

programe mbështetëse bizneset të cilat kanë objektiva të qartë zhvillimore, por që e kanë më vështirë të sigurojnë burime financimi për projektet e tyre në tregun e kapitalit.

13. Komunat (në bashkëpunim me Qeverinë) të hartojnë një plan pune për minimizimin dhe eliminimin e pengesave/vështirësive të të bërit biznes ashtu si janë identifikuar dhe analizuar në raportin e Bankës Botërore "Doing Business 2010".
14. MBPZHR tanimë ka përfunduar procesin e delegimit të kompetencës komunave për mbrojtje të pyjeve dhe dhënie të licencave për prerjen e drunjtve. Në këtë drejtim, rekomandohet rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të komunave për mbrojtje të pyjeve.

III. Projektligjet për vitin 2011 në Strategjinë Legjislative Qeveritare

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-090 mbi Partneritetin Publiko Private
2. Projektligji për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre
3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit
4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme
5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural
6. Projektligji për shërbimet këshillimore në bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë
7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për pyjet e Kosovës
8. Projektligji për komasacion të tokës bujqësore
9. Projektligji për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre 1 prill 2011;
10. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit 30 prill 2011.
11. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme 30 qershor 2011.

IV. Plani Vjetor i Punës për vitin 2011

Plani Vjetor i Kolegjiumit për vitin 2011 ka për qëllim të:

- organizoj punën e Kolegjiumit
- bashkërendoj idetë dhe lehtësoj/udhëheq zbatimin e aktiviteteve
- arritjen e objektivave të Kolegjiumit dhe AKK-së, dhe
- kontribuoj në përmirësimin e vetë-qeverisjes lokale në Kosovë

AKK ka organizuar takimin e Kryesisë së Kolegjiumit me 12 maj 2011 dhe ka përgatitur Planin e Punës për vitin 2011 ku në vija të trasha janë përcaktuar:

1. 2 prioritete
2. Objektivat
3. Aktivitetet
4. Datat (muajt) për takimeve gjatë vitit 2011

Plani i Punës është në përputhje me i) fushat strategjike të veprimit në kuadër të Strategjisë së AKK-së 2011-2015, ii) prioriteteve të identifikuara për vitin e kaluar 2010, iii) Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe v) çështjet e ngritura gjatë vizitave të AKK-së në të gjitha Komunat e Kosovës.

Ky Plan i Punës duhet të shihet si një dokument i cili ka nevojë për azhurnim dhe plotësim të vazhdueshëm në mënyrë që t'i përshtatet kërkesave dhe nevojave të komunave të Kosovës sipas situatës në teren.

Plani Vjetor i Punës për vitin 2011 për Kolegjumit për Zhvillim Ekonomik

		Takimi 1 Gjakovë 6 qershor	Takimi 2 Prishtine	Takimi 3	Takimi 4	Takimi 5 ???	Takimi 6
Prioriteti I	Krijimi i kushteve më të mira për bizneset						
Objektiva I.1	Lehtësimi i procedurave komunale për bizneset						
Aktiviteti I.1.1	Themelimi i one-stop shopeve në të gjitha komunat (për eliminimin e pengesave)	X					
Aktiviteti I.1.2	Praktikat e mira në lehtësira fiskale për bizneset lokale, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore (tax holidays)		Prezantim i alternativave të mundshme				
Aktiviteti I.1.3	Përsheptimi i bartjes së kompetencave për regjistrimin e bizneseve në të gjitha komunat	X					
Objektiva I.2	Kompletimi i infrastrukturës ligjore						
Aktiviteti I.2.1	Pjesëmarrja në GP legjislativë	X					
Objektiva I.3	Zhvillimi i Zonave ekonomike (ZE)						
Aktiviteti 1	Të bëhet fizibiliteti për të gjitha komunat për themelimin e ZE				X		
Aktiviteti 2	Thithja e donacioneve për themelimin e ZE për të cilat është kryer fizibiliteti				X		
	Punësimi zyrtarëve dhe mundësisht themelimi i zyreve komunale për turizëm				X		
Prioriteti II	Menaxhimi i pyjeve						
Objektiva II.1	Decentralizimi i kompetencave në fushën e pylltarisë						
Aktiviteti II.1.1	Rritja e stafit komunal në sektorin e pylltarisë			X			
Aktiviteti II.1.2	Bartja e kompetencave tjera (vula, etj)			X			

Raportimi për vitin 2011 dhe planifikimi për 2012

Bashkëpunimi ndërkomunal është aktivitet përcjellës – takimet e Kolegjiut do të mbahen në komuna të ndryshme dhe do të tentohet që çdo takim të përcillet edhe me ndonjë vizitë konkrete në zyrat relevante në komunë apo vizitë bizneseve.